



## KOMUNIKATË 21.11. 2009

Në mbledhjen e mbajtur sot, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve sipas rendit të ditës, shqyrtoi rekomandimin e Zyres për Regjistrimin e Partive Politike për mosakreditim të dy kërkesave për vëzhgues në Qendren e Numrimit të Rezultateve të subjekteve politike: AAK dhe PDK. Më 20 nëntor 2009, në ZRPP janë dorëzuar kërkesat nga përfaqësuesit e autorizuar për kontakte të këtyre dy partive politike, për akreditim të vëzhguesëve në QNR. Por pasi që këto kërkesa kanë arritur jashtë afatit ligjor për akreditim, ZRPP rekomandoi për mosakreditimin e këtyre vëzhguesve, dy të AAK-së dhe 1 vëzhgues të PDK-së. KQZ mori vendim që vëzhguesit e këtyre dy subjekteve në QNR, të mosakreditohen.

Në vazhdim të mbledhjes Burim Ahmetaj, koordinator i Qendrës së Numrimit të Rezultateve, e informoi KQZ-në për punën ditore që po bëhet në QNR. Sipas raportit, janë proceduar për t'u numëruar fletëvotimet me kusht të komunave të Gjakovës, Deqanit dhe të Kaçanikut, gjithsejt 1947 fletëvotime. Futja e të dhënave është duke u bërë sipas planit dhe, ka përfunduar skanimi i listave përfundimtare të votuesëve, si dhe është duke u bërë procedimi i fletëvotimeve me kusht, dhe janë proceduar fletëvotimet për nevoja të veçanta.

Auditimi është në proces e sipër, mirëpo është punuar me FRP-të për Kryetar Komune dhe për Asamblētë komunale. Z. Burim Ahmetaj, e ka informuar KQZ-në se, edhe 71 kuti gjenden në karantinë dhe janë të paketuara. Në arkiv, është bërë arkivimi i të gjithakutivëve në mënyrë të saktë dhe sipas planit të arkivimit.

Janë hetur 36 raste të marra nga karantina, e të cilave u kanë munguar fletët e Listës përfundimtare, të Listës përfundimtare me kusht, kopjet e nënshkruara gabimisht, zarfet e hapura etj.

Z. Burim Ahmetaj, koordinator i QNR-së, e ka informuar KQZ-në se në nivel të vendit, nuk janë hapur fare 77 Vendvotime. Për t'u mundësuar puna më efektive në QNR, z. Ahmetaj ka kërkuar që KQZ ta rrisë nivelin e tolerancës, deri në 9. KQZ e ka miratuar me vendim, kërkesën e QNR-së.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve sipas udhëzimeve të KZAP-it, ka marrë vendim që të bëhet rinumërimi i votave në 15 vendvotime dhe ky vendim, të filloj të ekzekutohet menjëherë.